

VENDIM
Nr.18, datë 12.1.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1058, DATË 21.10.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT MINIMAL TË REGJISTRIMIT PËR
TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR (TVSH)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1058, datë 21.10.2009 të Këshillit të Ministrave, paragrafi i dytë dhe i tretë të zëvendësohen me paragrafin, si më poshtë vijon:

“Ndërsa, për tatimpaguesit, që ofrojnë shërbime në veprimtari ekonomike, sipas profesioneve, të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, dentist, dentist i specializuar, farmacist, infermier, mami, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, dhe kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, si dhe në veprimtarinë ekonomike në fushën e hotelerisë, pavarësisht nga qarkullimi vjetor, kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në hiqet dhe të gjithë janë subjekte të TVSH-së.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 shkurt 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha